



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.11/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit B.Sh, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga A.G, nga fshati Q., K...e P..., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 25.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga A.G nga fsh. Q., K...e P..., ndaj gjyqtarit B.Sh, **SI E PABAZUAR**.

A r s y e t i m

Me datë 01.11.2024, A.G nga fsh. Q., K...e P..., ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit B.Sh, me arsyetimin se nga periudha 03.03.2023 e tutje në cilësinë e avokatit B.A e ka keqpërdorur besimin e tij, të cilit i ka thënë që të i'a jep 2500 euro se ka të njoftshëm në gjykatë dhe prokurori, si dhe ka detyruar që të flas fjalë të pavërteta që të del i pafajshëm. Thekson se ka qëndruar nëntë muaj në paraburgim dhe B.A i'a ka marr 2500 euro dhe i ka shkaktuar dëm 4300 euro. Ndër tjera thekson se i njëjti ka kërkuar 10000 euro nga M.G në prezencën e tij në koordinim me gjyqtarin B.Sh për të fituar një kontest pronësor në lagjen Fidanishtë, në Pejë, pavarësisht se M.G kishte dokumentet në rregull, i njëjti nuk i kishte dhënë të hollat dhe këta dy persona ja kishin humb kontestin. Tutje thekson se për të njëjtin gjyqtar ka kërkuar përjashtimi nga lënda por i është refuzuar për këtë arsye ia humbën kontestin pronësor vetëm se nuk i ka dhënë 10000 euro. Ndër tjera ka kërkuar që të merren masa ndaj gjyqtarit dhe avokatit.

Me datë 04.11.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga A.G, ndaj gjyqtarit B.Sh.

Gjyqtari B.Sh, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka deklaruar se e kundërshton në tërësi si të pavërteta dhe të trilluar. Ka njoftuar se lidhur me rastin ku i është keqpërdorur emri i tij në lëndën C.nr.2404/23, ku paditës ka qenë M.G nga fsh. Q., K...e P..., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av.N.H dhe av. B.A, dhe paditësi A.G, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av.N.H, kundër të paditurve Sh.L, A.L, R.L, të gjithë nga fsh.I..., K... e D..., të përfaqësuar sipas autorizimit nga av.I.O, me objekt kontesti vërtetimin e

pronësisë sipas kontratës gojore, e njëjta lëndë ka përfunduar me aktgjykimin e datës 24.05.2024, ka theksuar se do të njoftoj organet kompetente që të hetojnë këtë rast për keqpërdorimin e emrit të tij. Thekson se lidhur me pretendimet e parashtruesit në kërkesën për inicim të procedurës disiplinore për një rast ku i njëjti nuk ka qenë në dijeni deklaron se këto akuza nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, në analizën e theksimeve të parashtruesit është shumë e qartë se shumica e akuzave janë orientuar drejtë avokatit, ndërkohë emri i gjyqtarit është përmendur në një kontest që lidhet me një veprim për të cilin nuk ka njohuri dhe kjo situatë ngrit shqetësime rreth saktësisë dhe qëllimit të akuzave të paraqitura, andaj e konsideron të nevojshme që organet kompetente të njoftohen për këtë çështje. Tutje thekson se e kundërshton pretendimin e parashtruesit, ku emri i tij është keqpërdorur nga një avokat, këtë akuzë e konsideron të papranueshme, të pavërtetë dhe e dëmshme për reputacionin e tij profesionale. Përfundimisht thekson se nuk ka komunikuar në asnjë rrethanë me avokatët për çështje të lëndëve asnjëherë, një veprim i tillë është i ndaluar dhe përben një shkelje të rëndë të parimeve të drejtësisë, deklarohet se pretendimet e parashtruesit janë të paqëndrueshme dhe nuk pasqyrojnë realitetin e veprimeve të tij si gjyqtar, të cilat janë gjithmonë të drejtuara drejtësisë dhe ndershmërisë.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit B.Sh, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është dukshëm joserioze dhe e pabazuar.

Autoriteti kompetent vlerësoj pretendimet e parashtruesit të ankesës disiplinore, dhe ka gjetur se pretendimet që kanë të bëjnë me veprimet dhe pakënaqësitë që parashtruesi ka ndaj avokatit gjatë mbrojtjes në procedurat e zhvilluar kundërt tij, si kryetari i gjykatës nuk ka kompetencë të vlerësimit të këtyre pretendimeve andaj nuk do të lëshohem në elaborimin e tyre pasi që avokatët përgjigjen për shkelje të lehta dhe të rënda të detyrës dhe prestigjit të avokatisë para organeve disiplinore të Odës së Avokatëve, e jo para kryetarit të gjykatës.

Ndërsa për sa i përket pretendimit të parashtruesit të ankesës disiplinore se “avokati në fjalë i ka kërkuar 10000 euro nga M.G në prezencën e tij në koordinim me gjyqtarin B.Sh për të fituar një kontest pronësor”, emri i gjyqtarit vetëm është parafrazuar pasi që e terë ankesa e tij është orientuar drejtë pakënaqësive të avokatit në fjalë, mirëpo për veprimin e gjyqtarit apo siç pretendohet për koordinimin e avokatit me gjyqtarin lidhur me këtë kontest për të cilin parashtruesi as nuk është palë në procedurë e që sipas tij vetëm ka qenë prezentë kur avokati i ka kërkuar shumën prej 10000 euro M.G, nuk është arsytuar në asnjë mënyrë koordinimi apo veprimi i gjyqtarit në këtë drejtim andaj, në rrethana të tilla, e në mungesë të provave, Kryetari i Gjykatës si autoritet kompetent, e pati të pamundur të vërtetojë pretendimet e tilla, e në rastin konkret pretendim i parashtruesit të ankesës duke mos qenë i argumentuar mbetet vetëm një supozim i palës ankuese.

Për sa i përket pretendimit se për të njëjtin gjyqtar M.G ka kërkuar përjashtimi nga lënda por i është refuzuar për këtë arsye ia humbën kontestin pronësor vetëm se nuk i ka dhënë 10000 euro, kryetari i gjykatës ka konstatuar se parashtruesi i ankesës A.G në lëndën C.nr.2404/23 nuk ka cilësinë e palës në këtë procedurë, andaj në këto rrethana nuk mund që të lëshohem në elaborimin e rrethanave mbi të cilat është kërkuar përjashtimi dhe është refuzuar kërkesa për përjashtim,

ndërsa për pretendimin se është humbur kontesti pronësor vetëm se nuk është dhënë shuma prej 10000 euro, ky pretendim nuk gjë në mbështetje në asnjë provë të vetme dhe nuk është arsyetuar, andaj mbetet vetëm supozim i palës parashtruese.

Përfundimisht, autoriteti kompetent vlerëson se ankesa disiplinore në përgjithësi paraqet pakënaqësitë e parashtruesit të ankesës ndaj avokatit B.A për veprimeve që ka ndërmarr në cilësinë e avokatit gjatë mbrojtjes së tij në procedurën penale të zhvilluar kundrejt parashtruesit, veprime këto të cilat nuk janë kompetencë e vlerësimit të kryetarit të gjykatës si autoritet kompetentë, por janë subjekt i vlerësimit para organeve disiplinore të Odës së Avokatëve dhe autoriteteve tjera kompetente. Ankesa disiplinore e parashtruesit është e orientuar drejtë parafrazimit të emrit të gjyqtarit lidhur me një kontest gjyqësor, që parashtruesi i ankesës as nuk ka qenë palë në atë procedurë.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave autoriteti kompetent gjeti se ankesa disiplinore mbështetet vetëm në supozime të cilat nuk janë mbështetë në asnjë provë të vetme dhe si të tilla nuk përbëjnë shkak të argumentuar për të mbështetur dyshimin se gjyqtari ka kryer shkelje të natyrës disiplinore.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.11/24, me datë 25.11.2024

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit B.Sh*
- 3. Parashtruesit të ankesës – A.G, nga fsh. Q., K...e P...,*